



NË EMËR TË POPËLLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit Hasan Sadiku, me zyrtaren ligjore Hikmete Viliu-Pajaziti, në lëndën penale ndaj të akuzuarit B. A., nga Gjilani, për shkak të veprës penale Rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, PP.nr. 844/2017, të datës 29.05.2017, të cilën e e ka përfasuar prokurorja e shtetit Kujtesa Fazliu, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, më datën 31.07.2017 ndërsa më datë 01.08.2017 hartoi këtë :

AKT GJYKIM

I I akuzuari B. A., nga babai M. dhe nëna H., e lindur Krasniqi, i lindur më 01.02.1976, në fshatin, Komuna e Bujanovcit, tani me vendbanim në Gjilan, rr " " nr , Shqiptar, shtetas i Republikës së Serbisë. i martuar, baba i katër fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, vozitës në i gjendjes së varfër ekonomike, deri më tani i pa dënuar dhe nuk zhvillohet procedurë tjetër penale kundër tij.

Është fajtor

Më datë 14.05.2017, rreth orës 11:45 min. në rrugën publike të fsh. Komuna e Novobërdës, i akuzuari B. A., ka rrezikuar trafikun publik duke vënë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë e tyre, në atë mënyrë që duke e drejtuar automjetin e të markës " " me targa të regjistrimit nga fsh. në drejtim të Novobërdës, në të arritur para objektit të Zjarrfikësve në kryqëzimin e rrugëve, nga pakujdesia dhe në kundërshtim me dispozitën e nenit 61.4 Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor, nuk e ka respektuar shenjën e komunikacionit "Stop", për tu ndalur dhe dhënë përparsi kalimi automjeteve në lëvizje në rrugën kryesore me përparësi kalimi dhe pa u bindur se me një veprim të tillë nuk rrezikon pjesmarrsit tjerë në komunikacion fillon të kyqet në rrugën kryesore në drejtim të fsh. dhe me atë rast me pjesën e e parë të anës së djathtë të automjetit e goget në pjesën e djathtë, automjetin tjetër të udhëtarve të markës " " me targa të regj. të cilin i ka drejtuar L. M. e që në momentin kritik ishte duke lëvizur rrugës kryesore nga fsh. në drejtim të Novobërdës. Ku nga aksidenti i shkaktuar, pos dëmeve materiale të shkaktuara në të dy automjetet, lëndime trupore pësojnë edhe vozitësi i automjetit - L. M., dhe fëmiju i tij pasagjeri L. M. dhe pasagjerët e automjetit tjetër B. A., K. A., H. A., H. K. dhe B. K. të gjithë nga Gjilani, të

cilët për shkak të natyrës së lëndimev trupore, detyrohen që në Emërgjencën e Spitalit Rajonal të kërkojnë ndihm mjeksore.

- me këtë ka kryer veprë penale rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 41, 46, 73 dhe 74 të KPRK, si dhe nenit 365 të KPP, të akuzuarin:

E G J Y K O N

Me dënime me gjobë në shumë prej 250 (dyqind e pesdhjetë) euro, të cilën shumë i akuzuari ka për ta paguar në dy këste në afat prej 60 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari refuzon që ta paguaj dënimin me gjobë, ose nuk është në gjendje, ahter dënimi me gjobë do ti zavendsohet me dënim me burgim, ashtu që për cdo 20 euro të dënimin me gjobë do ti caktohet nga 1 (nji) ditë burgim.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjygjësor të i paguaj shumën prej 20€, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të dëmtuarit: L. M., L. M., B. K., K. K., H. K. dhe b. K., për realizimin e kërkesave pasurore juridike udhëzohen në kontestin civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën me shkrim PP.II.nr.844/2017 me datë 29.05.2017 kundër B. Azari nga Gjilani, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-ës.

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, të mbajtur më datën 31.07.2017, Prokurorja e Shtetit, Kujtesa Fazliu, ka deklaruar: në tërësi mbetem pranë aktakuzës së lartcekur, duke i propozuar gjykatës të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënojë me dënim meritor sipas ligjit, gjithnjë duke i marrë për bazë të gjitha rrethanat si ato lehtësuese ashtu edhe ato rënduese.

I akuzuaru B. Azari në seancë fillestare ka deklaruar: e ndiej vehten fajtor për veprën penale të cilën ma vënë në barrë aktakuza, pendohem për këtë veprë të kryer, dhe këtë pranim e bëj në mënyrë vullnetare andaj edhe i pranoj edhe pasojat dhe benefitet e këtij pranimi.

Me qenë se i akuzuari B. A., në shqyrtimin fillestar të kësaj çështje penale e ka pranuar fajsinë për të gjitha pikat e aktakuzës, e cila aktakuz ia venë në barrë veprën penale rrezikim i trafikut publik nga nenin 379 par 6 lidhur me paragraf 1 të KPRK-ës, e me këtë, sipas vlerësimit të kësaj gjykate gjendja faktike në këtë çështje penale nuk është kontestuese, sepse përpos pranimit të fajsisë nga ana e vet të akuzuarit, një pranim i tillë i fajsisë ka mbështetje në provat e grumbulluara që gjenden në shkresat e lëndës se i akuzuari vullnetarisht e ka pranuar fajsinë, se e ka kuptuar natyrën dhe pranimin e fajit, dhe se aktakuza nuk përmban as një shkelje të qartë ligjore, andaj gjykata vazhdoi procesin ndaj të njëjtit me shqiptimin e dënimit pa shkuar fare në shqyrtimin gjyqësor duke vepruar kështu në pajtim me dispozitën e nenit 248 par.4 të KPKsë, edhe pa fjaë përfundimtare të palëve.

Me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësinë së dënimit, për të akuzuarin B. A., gjykata i pati parasysh të gjitha rrethanat të cilat kanë rëndësi që dënimi të jetë më butë apo më i rëndë, ashtu si që e parashifet me dispozitën e neneve 73 dhe 75 të KPRK-ës. Kështu si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin gjykata pati parasysh pranimin e fajsisë qka do të thotë se i akuzuar ka pranuar të jetë bashkëpunues, është penduar për kryerjen e kësaj veprë penale, si dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të bie ndeshë me ligjin, gjendjen familjare se është baba i katër fëmijëve të mitur, si gjendjen e varfur ekonomike, Ndërsa si rrethanë rënduese për të akuzuarin gjykata pati parasysh shkallën e përgjegjesisë penale si dhe rrezikshmërinë shoqrore sikur edhe pasojat e veprës penale, andaj të njëjtit i shqiptoi dënim me kusht si në dispozitiv me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me ligj në mënyrë që i akuzuari në të ardhmen mos të kryeë veprë tjetër penale por që me një dënim të tillë të ndikohet edhe tek të tjerët për të mos kryer vepra tjera penale.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, është marrë në bazë të nenit 453 paragraf 1 lidhur me nenin 450 para.2 e 6 të KPPK-ës.

Venimi për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marrë në bazë të dispozitës së nenit 463 par. 1 të KPPK-ës

Nga të cekurat më lartë gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN -DEGA NOVEMBERDE

Departamenti i përgjithshëm

Më 01.08.2017

Zyrtarja ligjore,
Hikmete Veliu-Pajaziti,

